N.H. V.P. „IBËR-LEPENC" SH.A. D.D.
01-3076 Dt. 05-08-2024
PRISHTINË-PRIŠTINA



Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, neni 21 paragrafit 4, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligjin Nr.03/L-212 i Punës, Statutit Nr.08/868, të datës 30.05.2022, të NPH "Ibër Lepenc", si dhe Kodin e Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.08.2024 miratoi këtë:

# RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr.08/2913 TË DATËS 31.10.2023 PËR SISTEMATIZIMIN DHE PËRSHKRIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË NDËRMARRJEN PUBLIKE HIDROEKONOMIKE "IBËR – LEPENC" SH.A.

**PRISHTINË, GUSHT 2024**

## KAPITULLI I

## DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i rregullores Nr.08/2913 të datës 31.10.2024 për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës në ndërmarrjen publike hidroekonomike "Ibër – Lepenc" Sh.A.

### Neni 2

1. Në kuadër të departamentit të Departamenti "Uji Dhe Gjenerimi", shtohet: Shërbimi i Mirëmbajtjes së Liqenit, Digave dhe Infrastrukturës si në vijim:

**Shef i Shërbimit i të Mirëmbajtjes së Liqenit, Digave dhe të Infrastrukturës- (Numri i kryerësve 1)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Hartimi i planeve të mirëmbajtjes së rregullt dhe emergjente për digat dhe infrastrukturën percjellese deri në Kushtovë
- Organizimi dhe koordinimi i punës së ekipit të mirëmbajtjes dhe teknike.
- Monitoron në mënyrë të vazhdushme , liqenin e Ujmanit, Pridvorës, digat dhe infrastrukturën rreth tyre.
- Përcaktimi i prioriteteve të punës dhe alokimi i burimeve për realizimin e tyre
- Mbikëqyrja e inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të digave dhe strukturave të lidhura.
- Vlerësimi i gjendjes së strukturave dhe rekomandimi i masave për riparim apo përmirësim.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet e mirëmbajtjes kryhen në përputhje me standardet dhe rregulloret e sigurisë.
- Sigurimi që inspektimet të kryhen në përputhje me rregullat dhe standardet e sigurisë dhe mjedisit. Vlerësimi i performancës së stafit dhe motivimi i tyre për të arritur objektivat.
- Mbikëqyrja e nivelit të ndotjes në ujë dhe tokë për rreth digës.
- Përdorimi i teknikave dhe pajisjeve të avancuara për monitorimin e ndotjes
- Dokumentimi i gjetjeve dhe anomalive gjatë inspektimeve
- Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave për parandalimin e ndotjes.
- Koordinimi i aktiviteteve të pastrimit dhe restaurimit mjedisor në rast të incidenteve ndotëse.
- Bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe shtetërore për zbatimin e rregullave mjedisore.
- Informimi i komunitetit dhe palëve të interesuara mbi masat për kontrollin e ndotjes dhe përmirësimin e mjedisit.
- Zhvillimi i një mjedisi pune të sigurt dhe efektiv.
- Përgatitja dhe prezantimi i raporteve periodike për performancën e mirëmbajtjes dhe gjendjen e strukturave.

- Bashkëpunimi me autoritetet rregullatore dhe organizatat e tjera për të siguruar përmbushjen e kërkesave ligjore.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Drejtorit;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët Drejtorit të Departamentit.

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Edukimi Universitar në Inxhinieri Civile,inxhieri Mekanike, Inxhinieri Mjedisore, Ekonomik, Ekonomikë, Jurudikë apo fusha tjera sociale.
- Eksperiencë e konsiderueshme në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e objekteve
- Njohuri të thelluara të standardeve dhe rregullave të sigurisë dhe mjedisit.
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe të menaxhimit të ekipit.
- ftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi me autoritetet dhe komunitetin.
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Së paku 2 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi kompjuterike;
- Njohje të gjuhës angleze e preferuar.

Niveli i pagës në poena: 470

**<u>Kryepunëtor në Njësinë e mirëmbajtës së digave</u> - (Numri i kryerësve 1)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Planifikimi dhe koordinimi i punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve të përditshme në digë.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet të kryhen sipas planit të miratuar dhe në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë.
- Kujdeset për ruajtjen e pajisjeve dhe materialit ndërtimor ;
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e ekipit të punëtorëve të mirëmbajtjes.
- Shpërndarja e detyrave dhe mbikëqyrja e përmbushjes së tyre në kohë dhe me cilësi.
- Reagimi ndaj situatave emergjente dhe kryerja e riparimeve të shpejta për të siguruar integritetin e digës.
- Koordinimi me ekipet e tjera dhe autoritetet për të menaxhuar situatat kritike.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet të kryhen në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat mjedisore.
- Mbajtja e regjistrave të sigurisë dhe raportimi i incidenteve dhe aksidenteve.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të shërbimit;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët shefit të shërbimit

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 2 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Niveli i pagës në poena: 370

**Punëtor në Njësinë e mirëmbajtës së digave** - **(Numri i kryerësve 14)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Kryerja e punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve sipas planit të miratuar nga shefi apo kryepunëtori.
- Ndjekja e udhëzimeve dhe procedurave për të siguruar përmbushjen e standardeve teknike dhe të sigurisë.
- Kujdesi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe materialeve ndërtimore të përdorura në punë.
- Sigurimi që pajisjet janë në gjendje të mirë pune dhe të ruajtura në mënyrë të sigurt pas përdorimit.
- Ndihma në shpërndarjen e detyrave të punëtorëve të tjerë nën drejtimin e kryepunëtorit.
- Bashkëpunimi me ekipin për të siguruar përmbushjen e detyrave në kohë dhe me cilësi të lartë.
- Monitorimi i punëve të kryera për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe specifikimet teknike.
- Raportimi i problemeve dhe parregullsive tek shefi apo kryepunëtori.
- Reagimi i shpejtë ndaj situatave emergjente dhe kryerja e riparimeve të nevojshme për të ruajtur integritetin e digës dhe infrastrukturës për rreth.
- Përdorimi i pajisjeve të duhura dhe teknikat e shpejta për riparime emergjente.
- Kryerja e të gjitha aktiviteteve të mirëmbajtjes dhe riparimeve në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat mjedisore.
- Zbatimi i masave mbrojtëse për të siguruar një mjedis pune të sigurt.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të shërbimit apo kyepunetorit;

Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët shefit të shërbimit dhe kryepunetorit

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 1 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Niveli i pagës në poena: 300

**Kryepunëtor në Njësinë e Inspektimeve dhe kujdesit** - **(Numri i kryerësve 1)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Hartimi i planeve të inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- Koordinimi me menaxhmentin për të përcaktuar prioritetet dhe frekuencën e inspektimeve të natyrës pronësore dhe të vandalizimeve
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e ekipit gjatë inspektimeve vizuale dhe teknike
- Përdorimi i pajisjeve dhe metodave të avancuara për të monitoruar gjendjen strukturore dhe funksionale të digës.
- Regjistrimi i gjetjeve dhe anomalive të zbuluara gjatë inspektimeve.
- Përgatitja e raporteve të detajuara dhe rekomandimeve për veprimet e nevojshme. Koordinimi me ekipet e tjera dhe autoritetet për të menaxhuar situatat kritike.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet të kryhen në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat e sigurisë së digëve dhe pronës për rreth

- Mbajtja e regjistrave të sigurisë dhe raportimi i incidenteve dhe aksidenteve.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të shërbimit;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët shefit të shërbimit.

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 1 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Niveli i pagës në poena: 370

**Punëtor në Njësinë e Inspektimeve dhe kujdesit - (Numri i kryerësve 7)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Hartimi i planeve të inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të digës dhe pronës për rreth.
- Koordinimi me menaxhmentin për të përcaktuar prioritetet dhe frekuencën e inspektimeve, duke përfshirë inspektimet e natyrës pronësore dhe të vandalizmave.
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e ekipit gjatë kryerjes së inspektimeve vizuale dhe teknike.
- Sigurimi që inspektimet të kryhen në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat e sigurisë së digës dhe pronës për rreth.
- Përdorimi i pajisjeve dhe metodave të avancuara për të monitoruar gjendjen strukturore dhe funksionale të digës.
- Trajnimi dhe njohja e teknologjive të fundit për monitorimin e digës dhe infrastrukturës për rreth.
- Regjistrimi dhe dokumentimi i gjetjeve:
- Regjistrimi i gjetjeve dhe anomalive të zbuluara gjatë inspektimeve.
- Përgatitja e raporteve të detajuara dhe rekomandimeve për veprimet e nevojshme për të adresuar problemet e identifikuara.
- Koordinimi me ekipet e tjera dhe autoritetet për të menaxhuar situatat kritike dhe emergjente që lidhen me sigurinë e digës dhe pronës për rreth.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet të kryhen në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat mjedisore.
- Mbajtja e regjistrave të sigurisë dhe raportimi i incidenteve dhe aksidenteve tek shefi i shërbimit
- Dokumentimi i të gjitha aktivitetet e inspektimeve dhe masave të marra për të siguruar përputhshmërinë me standardet e sigurisë.
- Kryerja e detyrave të tjera sipas kërkesës së shefit të shërbimit.
- Fleksibiliteti për të marrë përsipër detyra të ndryshme për të ndihmuar në mbajtjen e sigurisë dhe funksionalitetit të digës dhe pronës për rreth.
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët shefit të shërbimit dhe kryepunetorit

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 1 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

Niveli i pagës në poena: 300

**Kryepunëtor në Njësinë e mirëmbajtës së infrastrukturës** - **(Numri i kryerësve 1)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Hartimi i planit të punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve për infrastrukturën për rreth digave dhe kanalit kryesore.
- Koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve ditore të mirëmbajtjes me ekipin e punëtorëve.
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e ekipit të mirëmbajtjes për të siguruar kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt dhe efikase.
- Organizimi dhe kryerja e punëve të mirëmbajtjes rutinore për rrugët, kanalet dhe strukturat ndihmëse për rreth digave.
- Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve të duhura për të kryer punët me cilësi dhe në kohë
- Përgatitja e raporteve të detajuara dhe rekomandimeve për veprimet e nevojshme.
- Koordinimi me ekipet e tjera dhe autoritetet për të menaxhuar situatat kritike.
- Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve dhe mjeteve të përdorura për mirëmbajtjen e infrastrukturës.
- Sigurimi që të gjitha pajisjet janë në gjendje të mirë pune dhe të sigurta për përdorim.
- Sigurimi që të gjitha aktivitetet të kryhen në përputhje me protokollet e sigurisë dhe rregullat e sigurisë së digëve dhe pronës për rreth
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së shefit të shërbimit;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët shefit të shërbimit
-

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 1 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

- Niveli i pagës në poena: 370

**Punëtor në Njësinë e mirëmbajtës së infrastrukturës** - **(Numri i kryerësve 5)**

*Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:*

- Hartimi i planit të punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve për infrastrukturën për rreth digave dhe kanalit kryesor.
- Bashkëpunimi me ekipin për të përcaktuar prioritetet dhe frekuencën e punëve të mirëmbajtjes.
- Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve ditore të mirëmbajtjes me ekipin e punëtorëve.
- Sigurimi që të gjitha punët janë të planifikuara dhe të koordinuara për të maksimizuar eficiencën dhe cilësinë.
- Drejtimi dhe mbikëqyrja e ekipit të mirëmbajtjes për të siguruar kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt dhe efikase.
- Shpërndarja e detyrave dhe monitorimi i përmbushjes së tyre sipas standardeve të kërkuara.
- Organizimi dhe kryerja e punëve të mirëmbajtjes rutinore për rrugët, kanalet dhe strukturat ndihmëse për rreth digave.
- Sigurimi që të gjitha punët rutinore kryhen në përputhje me planin e miratuar dhe me standardet teknike.

- Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve të duhura për të kryer punët me cilësi dhe në kohë.
- Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve dhe mjeteve të përdorura për mirëmbajtjen e infrastrukturës.
- Përgatitja e raporteve të detajuara dhe rekomandimeve për veprimet e nevojshme.
- Dokumentimi i gjetjeve dhe përgatitja e raporteve për menaxhmentin mbi punët e kryera dhe situatat kritike
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjët shefit të shërbimit dhe kryepunetorit.
-

*Aftësitë dhe kualifikimet:*

- Së paku përgatitja e mesme shkollore;
- Së paku 1 vjet përvojë pune ;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.

- Niveli i pagës në poena: 300

**Neni 3**

1. Rregullorja bazike, në kuadër të Departamentit "Uji dhe Gjenerimi", pozita e punës Drejtues i Kamionit, ndryshohet Niveli i pagës në poena nga 300 në 350.

2. Rregullorja bazike, në kuadër të Departamentit të Shërbimeve të Përbashkëta, pozita e punës Inxhinier i gjeodezisë dhe i Sistemit Gjeografik të Informimit (S.GJ.I.), ndryshohet Niveli i pagës në poena nga 550 në 520.

**Neni 7**
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Bordi i Drejtorëve.

Datë: 05.08.2024

Ndërmarrja Hidroekonomike "IBËR-LEPENC" sh.a. Vodoprivredno preduzeće d.d. Prishtinë-Priština

Bajram MUSTAFA
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
të NPH "Ibër Lepenc" Sh.A.